




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
Nr. i faq. 02
Broj stranica
Nr. pages

Nr. Prot. 01-2001/15
Br. Prot. Prot No.
Data 21.07.2015
Datum Date

PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	20.07.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-05/15
PËR/ZATO:	z. Bashkim Fazliu, Anëtar i Kuvendit Komunal në Ferizaj
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

I nderuari z. Fazliu,

Lidhur me kërkesën tuaj të drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit, ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I), Agjencia; “bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave”, (Neni 19 (paragrafi 1.5) i Ligjit nr.04/L-051), lidhur me kërkesën tuaj, Agjencia Kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Ushtrimi i funksioneve publike si Anëtar i Kuvendit Komunal në Ferizaj dhe njëkohësisht Koordinator i Sasp – it për Regionin e Ferizajt në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës Sh.A, nuk paraqet konflikt interesi dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

ARSYETIM

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar kërkesë nga z. Bashkim Fazliu – Anëtar i Kuvendit Komunal në Ferizaj, me numër të protokolit 03-02-712/15, në të cilin z. Fazliu ka kërkuar nga ne si autoritet kompetent për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, të shqyrtohet situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e dy funksioneve publike si Anëtar i Kuvendit Komunal në Ferizaj dhe njëkohësisht Koordinator i Sasp – it për Regionin e Ferizajit në Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës Sh.A.

Agjencia kundër Korrupsionit është institucion i pavarur të cilit me Ligj i janë besuar përgjegjësi të veçanta. Sipas nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia është autoritet qendror i cili ndër të tjera bënë edhe mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara ligjore.

Në nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është paraparë nocioni i konfliktit të interesit i cili përcakton se “konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”, ndërsa neni 4 i këtij ligji ka përcaktuar kategorinë e zyrtarëve të lartë publik, të cilët i nënshtrohen këtij ligji.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nr.04/L-051 ka përcaktuar kategorinë e zyrtarëve të lartë Publik të cilët e kanë obligim zbatimin e këtij Ligji, Në bazë të këtij Ligji pozita e Anëtarit të Kuvendit Komunal hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik.

Lidhur me pyetjen e dërguar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të interesit nuk ka përcaktuar ndonjë kufizim apo mospajtueshmëri në ushtrimin e funksioneve të lartcekura, prandaj ushtrimi i njëkohësishëm i këtyre funksioneve nuk paraqet konflikt interesi dhe mospajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë z. Fazliu, gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të ketë parasysh obligimin për deklarimin rast për rast të interesave lidhur me një vendimmarrje të caktuar, neni 13 paragrafi (1,2,3) i Ligjit Nr.04/L-051.

Me respekt!